



Republika e Kosovës
Republican Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 44/16

Prishtinë, më 10.02.2016, ora 11:10

Ndertesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Adem Grabovci, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Ilir Deda, Enver Hoti, Bali Muharremaj.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Kaltrina Ahmeti-nga KDI, Fjolla Uka - monitoruese nga KDI, Lumnije Murati - nga Zyra e Presidentit, Arte Myftari – nga Zyra e Presidentit, Valbona Puka-këshilltare ligjore nga Avokati i Popullit, Florina Ejupi- monitoruese nga BIRN, Arta Rexha-gazetare nga RrokumTV, Ardita Sylejmani-gazetare nga RTK, Muharrem Saraxholli - nga RTK, Albulena Mavraj-gazetare nga Epoka e Re, Melita Bytyci Kelmendi- nga PILPG, Kenf Fogg-nga PILPG, Kushtrim Kaloshi- nga ATRC.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli, Medina Agushi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 26.01.2016 dhe 29.01.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoi që rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 26.01.2016 dhe 29.01.2016

Kryetari - konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetari- theksoi ky projektligj bartë në vete kosto shtesë buxhetore për tu implementuar në vlerë prej 1,600,000 euro, për periudhën 2016-2017. Nga kjo shumë 400,000 euro kërkohen nga buxheti i Kosovës dhe 1,200,000 euro do të financohen nga Komisioni Evropian përmes Programit të IPA II. Ministria e Administratës Publike, kanë sqaruar se kostoja buxhetore prej 400,000 euro që ngarkohet buxheti i Kosovës, nëse nuk alokohet në ndarjet e rregullta buxhetore për vitin 2017, atëherë Ministria këtë shumë do ta financojë përmes mjeteve që ka paraparë në Projektin “Plani i Veprimtë për Reformën e Administratës Publike në Kosovë”, që është brenda buxhetit të kësaj ministrie.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxorri këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për Projektligjin nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
4. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuara nga nisma qytetare**

Kryetari – theksoi se Projektligji në fjalë është një nismë qytetare e nënshkruar nga 13,200 nënshkrime, për ndryshimin e Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, respektivisht për ndryshimin e nenit 69 të këtij ligji, me qëllim që të njihet e drejta e kompensimit, edhe të dëmeve joekonomike apo jomateriale, që vërtetohen nga gjykata kompetente ndaj ndonjë autoriteti publik apo organizate buxhetore. Projektligji në fjalë është miratuar në lexim të parë në seancë plenare. Qeveria, respektivisht Ministria e Financave, nuk ka arritur që të bëjë vlerësimin e koston buxhetore për zbatimin e këtij ligji, siç është kërkuar nga Kuvendi, dhe nëse komision funksional duhet të procedojmë më tutje. Ju e dini që me Kushtetutë dhe me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, parashihet që i dëmtuari ka të drejtë në

kompenzimin e arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata për dëmin material fizik dhe emocional prej të pandehurit, që është shpallur fajtor. Kjo asnjëherë nuk ka mundur të zbatohet, sepse ka qenë pengesë Ligji për Menaxhimin e Financave Publike që nuk e ka njohur një të drejtë të tillë të kompensimit të dëmeve jomateriale. Përndryshe, kompenzimi i dëmeve joekonomike është i rregulluar edhe me Konventën Europiane për të drejtat e njeriut në bazë të së cilës janë nxjerrur vendime nga Gjykatat Europiane për të drejtat e njeriut. Si grup punues, kemi shqyrtuar projektligjin dhe kemi propozuar dy amendamente:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit, të riformulohet me tekstin si vijon:

“Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116, nr. 04/L-194 dhe nr. 05/L-063”

Amendamenti 2

Neni 1, të riformulohet me tekstin si vijon:

Neni 1

Neni 69 i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

Neni 69 Dëmet e lejueshme

Gjykata kompetente është e autorizuar që ta urdhërojë një autoritet publik ose organizatë buxhetore, që të bëjë kompensimin në të holla për dëmet e shkaktuara materiale dhe jomateriale, të cilat janë vërtetuar nga gjykata, në bazë të provave me aktgjykim të formës së prerë.

Safete Hadergjonaj - ne e dimë që ky projektligj që është nismë qytetare është nënshkruar nga 13,200 qytetarë dhe nuk kanë qenë nënshkrime emocionale, siç është rasti me iniciativat tjera që kanë të bëjnë me situatat të ndryshme politike, por është çështja për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Projektligji ka kaluar në Kuvend në lexim të parë me 07.05.2015 dhe Kuvendi ka kërkuar që Qeveria ta procedojë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën përafrim me legjislacionin e Bashkimit Europian, brenda një muaji. Kjo nuk ka ndodhur dhe ne si Kuvend brenda rregullativës ligjore mund të procedojmë më tutje me projektligjin. Në gjatë punës tonë si grup punues kemi diskutuar gjatë në lidhje me këtë projektligj dhe jemi përpjekur që të gjejmë një lloj zgjidhje. Jemi bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku thuhet decitivisht: që personat për shqetësimet mendore që vijnë si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjes dhe i frikës dhe zgjatja e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe mungesa e dëmit material. Ky ligj është i pazbatueshëm, nëse nuk ndryshon Ligji për Menaxhimin e Financave Publike. Një çështje e tillë është e paraparë edhe me Kodin e Procedurës Penale, që parashihet që viktimat e krimit mund të kompenzohen për dëmet financiare, fizike dhe emocionale që shkaktohen si pasojë e veprave

penale. Ne si grup punues i kemi bërë ndryshimet dhe kërkojmë që të përkrahen këto amendamente dhe të procedohet më tutje në Kuvend.

Besa Gaxherri - ne kur kemi diskutuar për projektligj e kemi vlerësuar që është e arsyeshme dhe obligative ajo që kërkohet me këtë projektligj sepse Kushtetua ua garanton një gjë të tillë, por problemi është tek mungesa e vlerësimit të kostos buxhetore. Prandaj ju kemi ngarkuar si grup punues dhe është dashur paraprakisht që të takoheni me ministrin e financave dhe të na sjellni koston buxhetore, dhe ne pastaj ta aprovojmë dhe procedojmë më tutje.

Kryetari - ne i kemi kaluar afatet ligjore në procedimin e këtij projektligji. Përkundër afatit prej një muaji nga miratimi në lexim të parë, ministria e financave nuk e ka bërë vlerësimin e kostos buxhetore, që vlerësojë se është e vështirë të bëhet për shkak edhe të mungesës së të dhënave. Megjithatë ne duhet ta procedojmë më tutje për miratim këtë projektligj.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Komisioni propozon amendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuara nga nisma qytetare, si në vijim:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit, riformulohet me tekstin si vijon:

“Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116, nr. 04/L-194 dhe nr. 05/L-063”

Amendamenti 2

Neni 1, riformulohet me tekstin si vijon:

Neni 1

Neni 69 i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

Neni 69

Dëmet e lejueshme

Gjykata kompetente është e autorizuar që ta urdhërojë një autoritet publik ose organizatë buxhetore, që të bëjë kompensimin në të holla për dëmet e shkaktuara materiale dhe jomateriale, të cilat janë vërtetuar nga gjykata, në bazë të provave me aktgjykim të formës së prerë.

2. Raporti me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

5. Të ndryshme

5.1. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit

Kryetari – në mbledhjen e fundit të komisionit, kemi shqyrtuar dhe përkrahur Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit. Në ndërkohë është vërejtur se në tekstin e projektligjit janë disa gabime teknike, që konsiderojë që duhet ti rregullojmë përmes amendamenteve.

Në bazë të propozimeve të kryetari të komisionit, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Miratohen amendamentet në Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit, si në vijim:

Amendamenti 1

Në nenin 1 dhe në nenin 2, në rreshtin e dytë, hiqet fjala e parë “ndërmjet,”

Amendamenti 2

Neni 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 3

Dokumentet e bashkangjitura

Në Shtojcën 1 të këtij Ligji është e bashkangjitur Marrëveshja për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit.

2. Raporti me amendamente për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit, procedohet për miratim në Kuvend.

5.2. Shqyrtimi i kërkesës së Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) për ndarje të mjeteve Buxhetore për mbulimin e 70% të pagave bazë për ish anëtarët e Bordit të ARKEP-it

Kryetari – Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i ka drejtuar Komisionit një kërkesë që të ndahet buxhet për kompensimin e ish anëtarëve të Bordit të këtij autoriteti për një vit që nga përfundimi i mandatit të tyre. Arsyeshmëria e tyre është mbështetur

në rastin e kompensimit të deputetëve pas përfundimit të mandatit të tyre. Kjo kërkesë nuk ka bazë ligjore, pasi që kompensimi apo paga për deputetët që kanë përfunduar mandatin është e rregulluar me ligj dhe kjo nuk vlen edhe për ARKEP-in.

Në bazë të propozimeve të kryetari të komisionit, Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu kërkesën e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ndarje të mjeteve buxhetore për mbulimin e pagave bazë për ish anëtarët e Bordit të ARKEP-it, për shkak të mungesës së bazës ligjore për trajtimin e një kërkesë të tillë.

5.3. Njoftim lidhur me ecurinë e punës së Grupit Punues në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit

Bardhyl Meta – si grup punues po presim rinkofirmimin e Komisionit për të vazhduar me punën e monitorimit të Ligjit për Akcizën në Produktet e Duhanit. Unë mendojë që në përshkrimin e detyrave të punës së grupit punues, duhet të jetë theksuar se qëllimi primar është riaktivizimi i i kulturës së prodhimit të duhanit në Kosovë, si dhe kategorizimi i cigareve siç e kanë vendet tjera.

Kryetari – do të ishte e nevojshme që të bëhet një hulumtim lidhur me këtë qështje dhe ligjin në përgjithësi dhe në bashkëpunim me ministrin e financave, grup punues të përgaditen propozimet apo rekomandimet e procesit të monitorimit të ligjit, e pastaj i diskutojmë në komision.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani